

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“MEG GROUP ALBANIA” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 20.12.2024 , në Tiranë,

Z.Alban Hoti shtetas shqiptar, i lindur më 24.01.1980 në Bajram Curri, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numer personal :I00124022A.

I cili ka vendosur themelimin e shoqërisë **Meg Group Albania Shpk** , shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqeria **Meg Group Albania Shpk** ,është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat .Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqësimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **Meg Group Albania Shpk**.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Ofrimi i shërbimeve të marketingut dhe publicitetit, përfshirë krijimin, menaxhimin dhe ekzekutimin e strategjive promovionale dhe fushatave reklamuese në mediat tradicionale dhe digjitale.

Konsulencë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve të sistemeve informatike, përfshirë mirëmbajtjen, instalimin, dhe suportin teknik të softuereve dhe pajisjeve kompjuterike.

Konsulencë në fushën e kontabilitetit.

Ofrimi i konsulencës dhe shërbimeve për shoqëri kombëtare dhe ndërkombëtare.



NENI 4
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr."Sami Frasheri" Pallati Titan Konstruksion, Godina nr.8, Kati 2, Njesia Administrative Nr.10, zona Ish Ekspozita, Tirane , Shqiperi.

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është i ndarë në 1 kuote.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Z.Alban Hoti 1 kuotë, me vlerë 100 Lekë, zotëron 100%

NENI 6
Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 7
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë: **Z.Alban Hoti** shtetas shqiptar, i lindur më 24.01.1980 në Bajram Curri, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numer personal :I00124022A.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:

a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit



b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në dy kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES

